

FJALA E DEPUTETIT ISUF ÇELAJ

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

Të nderuar qytetarë të Tropojës, Hasit dhe Kukësit,

Të nderuar kolegë,

Më në fund, pas shumë përpjekjeve të deputetëve të opozitës, kërkesa e tyre për praninë e Kryeministrit në seancë për një mocion me debat dhe interpelancë pyetjesh lidhur me çështjen tashmë të njohur nga të gjithë si “skandali McGonigal” erdhi, megjithëse në shkëlqim të vazhdueshme nga ana juaj si mazhorancë të Kushtetutës së vendit dhe të Rregullores së parlamentit, sikur ta keni pronë private tuajën, duke harruar se kjo sallë dhe ky parlament janë të qytetarëve shqiptarë që na kanë votuar. Ju, duke mos miratuar kërkesën e 1/4-ës së deputetëve të opozitës për ngritjen e një komisioni hetimor për këtë çështje kaq sensitive, keni shkelur hapur Kushtetutën e vendit, konkretisht pikën 2 të nenit 77 të saj “Për ngritjen e komisioneve hetimore”. Por sado të mundoheni ta pengoni ngritjen e tij, nuk do të mund ta ndalni, pasi kjo e drejtë buron nga Kushtetuta e vendit dhe vullneti i shumicës së qytetarëve shqiptarë, që kërkojnë ngritjen e këtij komisioni. Charles McGonigal, një agjent dhe drejtues i një prej organizatave më prestigjioze të hetimit e të sigurisë të SHBA-së, siç është FBI-ja, aq të ngrohta i ka pasur marrëdhëniet me Kryeministrin Edi Rama, sa ka lënë gjurmë kudo ku ka shkelur, pa u shqetësuar aspak për ekspozimin e bëmave të tij në Shqipëri; një gjë shumë e rrallë për një profesionist të sojtit të tij! Kjo na le të kuptojmë se ose është treguar i paaftë, ose është një njeri që kishte garancinë e mikut të tij se këtu te ne mund të bënte çdo gjë për t’u kënaqur, mjaftonte vetëm të kryente misionin e kërkuar: goditjen e opozitës përpara autoriteteve amerikane (siç edhe ka rezultuar që e ka bërë), duke ndikuar në rezultatin e dy palë zgjedhjeve, rrjedhimisht duke ia dhënë zgjedhjet në tavolinë mikut të tij, Edi Rama. Unë nuk dua të flas për McGonigal-in si fenomen në raport me Ramën, pasi kjo doli e do të dalë nga fjalët e shumë kolegëve, por dua ta shoh përtej kësaj, pasi ajo që ka ndodhur me këtë personazh kalon çdo kufi të çmendurisë politike, agjenturore e me radhë.

Besoj se të gjithë e kanë parë se si ky drejtues i FBI-së, qartësisht me pushtet ndikues në politikën e madhe amerikane dhe me rol të fortë në organet hetimore amerikane, na është shfaqur serbes nëpër foto, duke ngrënë e duke pirë nëpër zyra, lokale e mejhane me drejtues të bashkive Kukës e Tropojë. Madje, krahas krahit me Damianin e “tërmeteve elektorale” më 23 shtator të vitit 2021 në një mejhane të Tiranës, i emëruari i Kryeministrit Edi Rama në Bashkinë e Tropojës i ka dorëzuar medaljen “Mirënjohje e Tropojës”. Pa iu dridhur fare qerpiku, McGonigal me krahit e ngrohur nga Gjyknuri i partisë ka marrë titullin, të thuash se ka qenë ndonjë kontribuues i madh për Tropojën e tropojanët! E vetmja lidhje e tij me Tropojën, e cila është provuar, është personi i përfolur që ka realizuar lidhjen e tij me Kryeministrin dhe të besuarin e tij Dorian Duçka dhe tropojanin e amerikanizuar, Agron Neza. Po pse, për këtë miqësi, një drejtor i FBI-së, i korruptuar nga Edi Rama, duhet të nderohet nga Bashkia e Tropojës?! Unë nuk gjej dot arsye, ndaj si deputet i zgjedhur nga vota e qytetarëve të qarkut të Kukësit po ju drejtoj disa pyetje, të cilat sot i drejton çdo qytetar i zonës: cili është motivi i akordimit të medaljes “Mirënjohje e Tropojës” McGonigal-it? Si është arsyetuar në certifikatën e dhënë nga i emëruari pa votë në Bashkinë e Tropojës? Çfarë ka bërë McGonigal-i për Tropojën? Çfarë ka bërë McGonigal-i për tropojanët? Cili është kontributi i tij për Bashkinë e Tropojës? A kanë ndikuar

investimet amerikane për Kukësin, Hasin dhe Tropojën? A mund të na thoni se çfarë ka bërë ky njeri për të merituar medaljen më të lartë që jep bashkia, “Mirënjohje e Tropojës”? Pse shoqërohej i kapardisur nga Damian Gjijnuri, apo sepse për raste të tilla duhet të bëhet edhe tërmet zgjedhor?

Unë e di që McGonigal-i nuk ka asnjë meritë për Tropojën, sepse as e ka ditur se ku binte në hartë e jo më të ketë ofruar diçka si kontribut. Jo, ai as e di se kush janë tropojanët. E vetmja meritë e tij është se ishte miku i Ramës dhe i “rilindësve” të tij dhe për këto arsye ai shëtiste kapardisur nëpër ceremoni, dreka, darka, si dhe fluturime me helikopter nëpër pikat turistike të vendit, duke sajuar intriga e dëshmi për dëshmitarë të rremë kundër PD-së e lidhshimit të saj. Po me Kukësin çfarë e lidh ish-drejtorin e FBI-së? Pse shtrohej në dreka e darka me mish e raki nga kryetari tjetër i pavotuar i Bashkisë së Kukësit, pasionant gjigant i mishit? Po për Kukësin çfarë kishte bërë vallë agjenti i FBI-së? Çfarë meritash kishte ai për të merituar qengjin e pjekur në hell e rakinë ballë kazani të servitur nga i emëruari i Bashkisë së Kukësit? Janë shumë pyetje që ngrihen për këtë çështje, por banorët e qarkut të Kukësit duhet ta dinë pse kanë ndodhur këto çudi në vendin e tyre. Pse janë përdorur këto dy bashki për të kënaqur egon e sëmure të Kryeministrit dhe të mikut të tij manipulator të FBI-s? Ju për këtë nuk keni përgjigje, por normalisht jeni kujdesur që këtij njeriu t’i plotësoheshin sa më shumë kënaqësi, sepse ai duhej të bënte ato që donte Kryeministri: të godiste opozitën dhe t’i hapte rrugën çimentimit të pushtetit të regjimit pseudodemokratik rilindës. McGonigal-i nuk mund të jetë dhe as nuk duhet ta mbajë medaljen “Mirënjohje e Tropojës”. Është e turpshme që një “nder” i tillë të përdoret si korrupsion për një drejtues të FBI-së, i cili së bashku me çantat me para që merrte prej miqve të Kryeministrit, joshëj ta shkatërronte sa më shumë Partinë Demokratike. Kam një thirrje për qytetarët e Kukësit, Hasit e Tropojës, që t’i përgjigjen me votë kësaj marrje të pushtetit e t’i kthejnë bashkitë në duart e tyre, duke i dhënë fund regjimit të të emëruarve. Më 14 maj votohet për t’i hequr njëherë e mirë ata që për të kënaqur Kryeministrin, janë gati të bëjnë gjithçka në kurriz të qytetarëve, por mos harroni se qytetarët e Tropojës, Hasit e Kukësit do t’ju ndëshkojnë me votë, ashtu siç ju kanë ndëshkuar sa herë ka pasur zgjedhje, si lokale, ashtu edhe parlamentare. Këta qytetarë e kanë më se të qartë se gjatë këtyre 10 vjetëve të qeverisjes suaj janë ndëshkuar politikisht vetëm e vetëm se kanë votuar Partinë Demokratike dhe që shkaktarët e varfërisë ekstreme, të mungesës së investimeve dhe shpopullimit masiv të këtyre zonave jeni ju si pseudomazhorancë. Edhe pse keni përdorur të gjitha makinacionet tuaja për ta blerë varfërinë e tyre me para dhe favore të ndryshme si punësime, presione me para, patronazhistë e aktivistë, nuk do t’ia dilni dot ta deformoni vullnetin e tyre, si dhe gjënë më të shenjtë të malësorëve të këtij qarku: dinjitetin dhe krenarinë shekullore! Faleminderit!